



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 1551 date 29.06.2005

Nr 4643 date 01.07.2005

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr 150/1 date 01.07.2005

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR

**DETYRAT, PERGJEGJESITE, FORMAT DHE PROCEDURAT E
BASHKËRENDIMIT E TE INFORMIMIT NDËRMJET
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE**

Ne mbështetje te pikës 4 te nenit 102 te Kushtetutës, te pikës 4 te nenit li te ligjit Nr. 9205, date 15.3.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë",

UDHËZOJMË:

1. Institucionet e sigurisë kombëtare dhe organet shtetërore kur përfshihen ne procedurat e mbrojtjes se dëshmitareve dhe bashkëpunëtoreve te drejtësisë, pe zbatimin e ligjit nr. 9205, date 15.03.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dt Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë" bashkëpunojnë me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrin e Rendit Publik, Ministrin e Drejtësisë, Sektorin e Mbrojtjes si Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë dhe Komisionin për Vlerësimi e Masave te Posaçme te Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve t(Drejtësisë.
2. Institucionet dhe organet shtetërore bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë njoftime dhe informacione jo vetëm për personat qe janë përfshire ne programin e mbrojtjes por edhe për personat e afërm ose te lidhur me ta.
3. Komisioni për Vlerësimin e Masave te Posaçme te Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë ka te drejte t'i beje pyetje e propozim Sektorit te Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë, institucioneve qendrore, organeve te pushtetit e te administratës dhe te kërkoj prej tyre shpjegime për çdo çështje qe ka te beje me përmbushjen e detyrës për mbrojtjen e personit qe do te merret ne mbrojtje. Këto organe janë te detyruar t'i shqyrtojnë pyetjet e propozimet e bëra dhe t'i përgjigjen Komisionit brenda 13 ditëve nga data e paraqitjes se tyre.

4. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë ju parashtron organeve përkatëse kërkesat, ankesat, vërejtjet dhe propozimet e bëra nga personat e mbrojtur. Këto organe duhet t'i marrin në shqyrtim dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes të njoftojnë Komisionin për mënyrën e zgjidhjes së tyre.
5. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë brenda 7 ditëve, nga dita që Komisioni ka marrë përgjigjen nga organet përkatëse, duhet të informoj personin e mbrojtur për mënyrën e zgjidhjes së kërkesave ose ankesave, masave të marra ose për motivet e mospranimit.
6. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë kur vëren se nëpunësi apo punonjës të ndryshëm nuk i kryejnë detyrat apo shkelin ligjin dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe zbatim të ligjit "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë" kërkon nga organet kompetente marrjen e masave përkatëse ndaj personave fajtor. Këto organe janë të detyruara që brenda 15 ditëve të shqyrtojnë kërkesën dhe të njoftojnë Komisionin për masat që kanë marrë.
7. Organi kompetente për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të bashkëpunëtorëve të drejtësisë është Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë. Këto kërkesa dhe ankesa Komisionit i përcillen nga organet drejtuese të Administratës së Burgjeve, ku bashkëpunëtori vuan dënimin.
8. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në çdo rast njofton dhe mund të kërkojë ndërhyrjen e organeve eprore të institucioneve që janë të ngarkuara me zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, për të mbikëqyrur ekzekutimin si dhe për të kryer verifikimet përkatëse duke marrë masa të menjëhershme për konstatimet e vërejtura dhe kërkesat e Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.
9. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë menjëherë pas paraqitjes së propozimit sipas nenit 13 të ligjit nr. 9205, datë 15.03.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë" vendos kontakte me personat e afërm ose të lidhur me personin për të cilin është propozuar zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes, si dhe mund të kërkojë ia organet shtetërore informacion shtesë mbi përshtatshmërinë e personave për përfshirjen e tyre në masat e posaçme të mbrojtjes.
10. Për ndryshimin, heqjen ose përfundimin e masave të posaçme të mbrojtjes, pas marrjes së vendimit nga Komisioni Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë sipas rastit njofton me shkrim Prokurorin,

Ne rastet e heqjes ose përfundimit të masave të posaçme të mbrojtjes Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë njofton strukturat e Policisë së Shtetit për vendbanimin / vendqëndrimin e personit të cilit i janë hequr ose përfunduar masat e mbrojtjes. Strukturat e Policisë së Shtetit marrin masa të zakonshme mbrojtje të mjaftueshme për përballimin e rreziqeve, të mundshme, nëse rreziqet bëhen konkrete, aktuale dhe serioze për jetën këto struktura i drejtohen për vlerësim nëpërmjet informacioneve të hollësishme Prokurorit të Përgjithshëm.

11. Vendimet e Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë i njoftohen Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë me njoftime të veçante, në të cilën nuk bëhen të ditura të dhëna për kontributin e bashkëpunëtorit dhe procedimin penal. Në njoftim Sektori detajon detyrimet e organeve shtetërore, si dhe mënyrën e zbatimit të vendimit të Komisionit. Kjo procedurë ndiqet edhe për vendimet e Komisionit, të cilat ndryshojnë, heqin ose përfundojnë masat e posaçme të mbrojtjes.

12. Në rastet kur personi i mbrojtur është shtetas i huaj, refugjat apo person pa shtetësi Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme duhet të informojë dhe koordinojë veprimet për të krijuar personit lehtësitë e nevojshme për komunikim me përfaqësuesit diplomatike ose konsullore në Republikën e Shqipërisë, të shtetit të cilit ai i përket, përfaqësuesit të shtetit që merr përsipër mbrojtjen e interesave të tyre, ose autoritetet kombëtare apo ndërkombëtare, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.

13. Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në çdo rast bashkëpunimi me prokurorin e procedimit penal, në të cilin personi i mbrojtur ka dhënë kontributin e tij bashkëpunues, mbi bazën e marrëveshjes, do të synojë përcaktimin e drejte të përgjegjësive, të drejtave, detyrimeve dhe efektet e marrëveshjes sipas neneve 16 e 17, të ligjit nr. 9205, datë 15.03.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë".


14. Për përdorimin e dokumenteve identifikuese fiktiv për personat e mbrojtur, pas administrimit të autorizimit me shkrim nga Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Shefi i Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë i kërkon organeve kompetente ekzemplare të bardhe/ paplotësuar të kartave të identitetit dhe të dokumenteve të tjerë të identifikimit.


15. Bashkëpunëtorët e Drejtësisë që vuajnë dënimin me burgim, duke mos përjashtuar klauzolën e vullnetit të bashkëpunimit, sistemohen në institucione ose seksione të veçanta të tyre të përcaktuara posaçërisht me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.


16. Drejtuesit e institucioneve te vuajtjes se dënimit me burgim/ paraburgim janë te detyruar te njoftojnë Sektorin e Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë për çdo kërkesë dhe ankese te bashkëpunëtorit, sipas ligjit nr. 8328, "Ter te drejtat dhe trajtimin e te dënuarve me burgim". Komunikimi dhe kontaktet e personelit te Sektorit te Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë me bashkëpunëtoret qe vuajnë dënimin me burgim ose janë te paraburgosur janë te pa kufizuara,

17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Komisioni për Vlerësimin e Masave te Posaçme te Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë, Sektori i Mbrojtjes se Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve te Drejtësisë, strukturat përkatëse ne Ministrinë e Drejtësisë, Prokuroret e Gjykatave te Shkalles se Pare dhe Prokuroret e Prokurorisë se Krimeve te Renda.

Ky udhëzim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RENDIT PUBLIK
Igli ROSKA

REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTRI
TIRANE
E RENDIT PUBLIK

MINISTRI I DREJTESISE
Fatmir XHAFAJ

REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE

PROKURORRI PERGJITHSHEM
Theodhor SOLLAKU

REPUBLICA E SHQIPERISE
PROKURORIA PERGJITHSHEM
TIRANE

